

BULETINI



Buletini është publikim i KOSTT sh.a,

Rr. Iljaz Kodra p.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381(0) 38 501 601 174 ; email: info@kostt.com

Web: www.kostt.com

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:

Zana Bajrami-Rama, menaxhere për komunikim

zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| • Arritjet e KOSTT ne kater vitet e fundit | 4 |
| • Nënshkruhet Kontrata për shërbime të konsulencës për linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri | 6 |
| • Mirënjohje për RF të Gjermanisë dhe Republikën e Kosovës në prag të megavateve të parë në Nënstacionin Peja 3 | 7 |
| • Implemetohet me sukses projekti I servisimit të rregullatorëve të tensionit | 8 |
| • Puna dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT | 8 |
| • Drejt tregut rajonal të energjisë elektrike: Çështjet e transmisionit sot dhe përfshirja e KOSTT-it | 9 |
| • Kapacitetet Njerëzore në KOSTT | 10 |
| • Emërohen anëtarët e rinjë të Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike/Operacionale | 10 |
| • Vendimet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për periudhën Maj, Qershor, Korrik, Gusht 2009 | 11 |
| • Forumi Ndërkombëtar “Kosova - Mundësi Energjetike” | 11 |



Fadil Ismajli
Drejtor Menaxhues i KOSTT sh.a

Arritjet e KOSTT në katër vitet e fundit

KOSTT ka trashëguar rrjet tejet të vjetër dhe jo te mirëmbajtur si duhet, i cili me vështirësi të mëdha ka përballuar kërkesën për energji elektrike gjithnjë në rritje. Prandaj, që nga themelimi, synim kryesor ka qenë mirëmbajtja adekuatë dhe zhvillimi i rrjetit të transmisionit që të përballoj kërkesën në rritje për energji elektrike dhe të operoj në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme sistemin elektroenergjetik.

Ulja e numrit të rënieve në linja dhe transformator, si dhe eliminimi i fyerave të ngushta në mënyrë që të rritet siguria dhe besueshmëria e sistemit janë aktivitete me të cilat sigurohet realizimi i qëllimeve të parashtruara. Kjo kryesisht realizohet nëpërmjet implementimit të një programi të ngjeshur të mirëmbajtjes, edhe pse kjo ishte një sfidë e jashtëzakonshme në pikëpamje të

operimit dhe realizimit të shkyçjeve. Të gjitha projektet e mirëmbajtjes të implementuara gjatë katër viteve të fundit janë realizuar me sukses dhe pa asnjë aksident të rëndë në punë.

Mirëmbajtja e intensifikuar gjatë viteve të kaluara ka treguar rezultate të prekshme, kjo lehtësisht mund të krahasohet me numrin e prishjeve në linjat e transmisionit gjatë vitit 2007 krahasuar me vitin 2008, dhe vitin 2008 krahasuar me vitin 2009.



Zvogëlimi i prishjeve në linja është tregues konkret i rezultateve të mirëmbajtjes adekuatë dhe përmirësimit të gjendjes së SEE. Pra, numri i rënjeve në linjat e transmisionit për vitet 2008/2007 janë rreth 32% më të vogla, ndërsa për vitet 2009/2008 rreth 61%.

Gjatë tërë kësaj kohe mirëmbajtja ka qenë në fazën emergjente dhe tani (që nga viti 2010) kalohet në mirëmbajtje të planifikuar dhe preventive.

Paralelisht me mirëmbajtjen e intensifikuar implementohen edhe shumë projekte kapitale të cilat ndjeshëm ndikojnë në rritjen e kapacitetit transmetues si dhe besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit.

KOSTT është ballafaquar me shumë fyer të ngushta në rrjetin e transmisionit. Siç është rasti i linjës NS Kosova A – NS Vushtrri në të cilën është ndërruar përçuesi konvencional me përçues “hot wire” i cili ka rritur ndjeshëm kapacitetin bartës të kësaj linje, sikurse edhe në linjën NS Prizreni 1 – NS Prizreni 2. Ndërsa deri në fillimin e sezonit dimëror 2009/2010 me lëshimin në punë të NS Peja 3 do të eliminohen fyeret e ngushta në Rrafshin e Dukagjinit. Ndërsa fyeret e ngushta në pjesën juglindore të Kosovës do të eliminohen me instalimin e transformatorit të ri 150MVA në NS Kosova A dhe rehabilitimin e linjës Kosova A-Shkupi.

Vlera e projekteve kapitale sipas efektit në rrjet është paraqitur në diagram.



Në kater vitet e fundit ka pasur një vëllim të jashtëzakonshëm të investimeve kapitale, të cilat si efekt kanë pasur ngritjen e kapaciteteve transmetuese dhe rritjen e sigurisë së Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës.

Si rezultat i implementimit të projekteve kapitale janë ngritur dukshëm edhe kapacitetet transmetuese. Kështu, sipas Bilancit Elektroenergjetik (BE) 2007 ngarkesa e lejuar ka qenë 850 MW (ndërkaq është realizuar ngarkesa e pikut 933MW), sipas BE 2008 ngarkesa e lejuar ka qenë 880 MW (ndërkaq është realizuar 976 MW) sipas BE 2009 të planifikuar, ngarkesa e lejuar është 930 MW, ndërkaq duke qenë se gjatë këtij viti dhe fillimit të vitit 2010 do të përfundojnë Projekte kapitale, kapacitetet transmetuese do të rriten në 1250 MW.



Pra, investimet kapitale kanë dhënë efekt në rritjen e vëllimit dhe ngarkesës së energjisë së furnizuar gjë që ka plotësuar kërkesat e klientëve tanë, dhe është reflektuar pozitivisht edhe te konsumatori i fundit.

Angazhimi dhe përkushtimi për operim të sigurtë dhe implementimin e projekteve investive ka ndikuar në reputacionin e KOSTT, duke ngritur besimin te donatorët e ndryshëm dhe institucionet financiare. Që nga pas lufta e deri më tani janë implementuar apo janë në proces të implementimit 28 projekte me vlerë rreth 99 milionë Euro, pjesa më e madhe e të cilave pas themelimit të KOSTT. Këto projekte janë financuar pjesërisht nga donacionet, si nga Komisioni Evropian, Qeveria Gjermane përmes Bankës për Zhvillim-KfW dhe nga Buxheti i Kosovës.

Që nga viti 2010 KOSTT hyn me plan të mbulimit të pjesës dërmuese të Investimeve kapitale me mjete vetanake përmes kredive të buta të infrastruktures që është një hap i sigurtë drejt zhvillimit të mirefillt dhe valorizimit të aseteve dhe pasurisë së vet. Shembull i parë është financimi i Transformatorit 150MVA në Prishtinë-4 dhe tani besojmë në akordimin e kredive nga KfW për ndërtimin e linjes 400kV Kosove – Shqipëri.

Një ndër preokupimet kyçe të menaxhmentit të KOSTT që nga themelimi, mbetet i rrafshi ndërkombëtar, ku përkundër sfidave të shumta ka pasur zhvillime pozitive. Duke qenë palë e re në proceset e integritimeve rajonale ne kemi hasur në vështirësi sa i përket pjesëmarrjes në proceset dhe mekanizmat rajonal. Falë angazhimit të fuqishëm të menaxhmentit, ne kemi arritur që të inkuadrohemi në shumicën e këtyre mekanizmave dhe të forcojmë pozitën tonë në rajon. Megjithatë, për shkak të statusit politik të pazgjidhur deri para një viti të vendit tonë, në disa aspekte siç është kompensimi i transitit dhe alokimi i kapaciteteve ne vazhdojmë të hasim në vështirësi.

Përkundër kësaj, është arritur të sensibilizohen institucionet vendore dhe evropiane lidhur me problemet me të cilat ballafaqohemi dhe lirisht mund të them se kemi fituar mbështetjen dhe përkrahjen e akterëve kyç në këto procese. Lidhur me këtë kemi për synim që gjatë vitit 2010 të bëhemi anëtarë i plotë i ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity) organizatë e cila ka absorbuar në vete funksionet e ETSO (European Transmission System Operators) dhe UCTE (Union for Coordinated Transmission of Electricity).

Natyrisht, të gjitha aktivitetet e përmendura janë mbështetur me burime financiare të cilat janë menaxhuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të cilat janë audituar nga revizori i pavarur, i cili në raportet e veta nuk ka nxjerr asnjë kualifikim për tri vite fiskale radhazi, e që është sukses ndër ndërmarrjet publike në Kosovë.

Të gjitha këto suksese janë arritur falë angazhimit dhe përkushtimit maksimal të menaxhmentit dhe punëtorëve të KOSTT. Po ashtu, nga të gjitha që u përmendën më sipër shihet se rëndësia e cila i është kushtuar aftësisht profesional, trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore ka dhënë frytet e veta.

Ne mbesim të përkushtuar të vazhdojmë punën me një elan të shtuar, dhe edhe më tej të zhvillojmë KOSTT si një ndërmarrje të vetë-qëndrueshme financiarisht dhe shembull në Kosovë dhe më gjerë.

Nënshkruhet Kontrata për shërbime të konsulencës për linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri

Në vazhdimësi të prezantimit të veprave konkrete të bashkëpunimit 10 vjeçar në mes të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Kosovës, me 24 shtator 2009, në Nënstacionin Peja 3 në Istog u nënshkrua Kontrata për shërbime të konsulencës për linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, projekt i cili është financuar nga RF e Gjermanisë, përmes Bankës për Zhvillim (KfW).

Kryeministri i Republikës së Kosovës z.Hashim Thaqi i cili ishte prezent në ceremoninë solemne së bashku me zv.Kryeministrin z.Hajredin Kuqi, Ministren e Energjisë dhe Minierave znj.Justina Shiroka-Pula dhe Ministrin e Ekonomisë dhe Financave z.Ahmet Shala, theksoi se “Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, ne po hedhim hapin e parë në implementimin e këtij projekti madhor, i cili ka një rëndësi të jashtëzakonshme për vendet tona, si dhe për rajonin në përgjithësi “Ka qenë ky një projekt i ëndërruar dhe sot po bëhet realitet, theksoi Kryeministri Thaqi.

Kontrata për shërbime të konsulencës për linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, parasheh që shpallja e tenderit të bëhet në pjesën e parë të vitit 2010 deri sa pas përfundimit eventual me sukses të procesit të kontraktimit, sipas planit parashihet që ndërtimi i linjës të fillojë në kuartalin e 4-të të vitit 2010. Projekti përfshinë ndërtimin e linjës 400kV me gjatësi 238 km nga të cilat 85.5 km janë në pjesën e Kosovës. Kostoja e ndërtimit për pjesën e Kosovës parashikohet të jetë diku rreth 33mil € nga të cilat 17mil € kredi e butë dhe 16 mil € grant nga RF e Gjermanisë.

Drejtori menaxhues i KOSTT z.Fadil Ismajli, duke folur për rëndësinë e projektit i cili njëherit cilësohet edhe si “autostrada energjetike”, falënderon Qeverinë Gjermane për përkrahjen financiare të projektit dhe Qeverinë e Kosovës për përkrahje të vazhdueshme, ndërkaq Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) e vlerëson si partner strategjik të KOSTT.

Aktualisht, Kosova dhe Shqipëria kanë në dispozicion një linjë interkonektive 220 kV, ndërkaq me ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV, pritet që të pesëfishohet kapaciteti i transaksioneve në mes të dy vendeve dhe me këtë të krijohen kushtet e volitshme për shkëmbimin më të madhë të energjisë në mes të dy vendeve sidomos pas ngritjes së kapaciteteve gjeneruese të planifikuara në Kosovë të bazuara në linjit si dhe të kapaciteteve gjeneruese hidro të Shqipërisë.



Mirënjohje për RF të Gjermanisë dhe Republikën e Kosovës në prag të megavateve të parë në Nënstacionin Peja 3

Në shenjë mirënjohje për Republikën Federale të Gjermanisë dhe Republikën e Kosovës për bashkëfinancimin e Projektit Peja 3, KOSTT sh.a ka përgatitur një pllakë falënderuese për të dy vendet e cila është vendosur në objektin e saponërtuar të Nënstacionit Peja 3 në Istog. Implementimi i Projektit Peja 3 ka filluar në Nëntor të vitit të kaluar, ndërkaq megavatët e parë pritet që të kalojnë përmes këtij Nënstacioni në pjesën e parë të muajit Nëntor, ka theksuar drejtori menaxhues i KOSTT z.Fadil Ismajli. Sikurse Kryeministri i Kosovës z.Hashim Thaqi, ashtu edhe z.Friedrich Kitschelt zv.Drejtor General dhe Komisioner për Azi, Evropë Juglindore dhe Afganistan nga Ministria për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik të RF të Gjermanisë kanë shprehur mirënjohje për punën e KOSTT-it. Me përfundimin e Paket Projektit Peja 3 do të eliminohen fytet e ngushta në pikëpamjen e transmisionit në Rrafshin e Dukagjinit si dhe do të ndikojë dukshëm në rritjen e kapaciteteve transmetuese të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, me përfundimin e këtij projekti do të rritet siguria dhe besueshmëria e operimit të rrjetit transmetues



Implemetohet me sukses projekti i servisimit të rregullatorëve të tensionit

Realizimi i servisimit të rregullatorëve të tensionit është pjesë e rëndësishme e mirëmbajtjes së pajisjeve të rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike e cila është e paraparë që të realizohet çdo 6 (gjashtë) vite. KOSTT këtë vit ka realizuar me sukses projektin për servisimin e rregullatorëve të tensionit në disa Nënstacione: NS 220/110 kV Prizreni 2, NS 220/110 kV Prishtina 4, NS 220/110 kV Kosova A, i cili është implementuar nga kompania Konçar nga Kroacia. Realizimi i servisimit të rregullatorëve të tensionit në radhë të parë ndikon në jetëgjatësinë e pajisjeve dhe gjithashtu edhe në ngritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit.

Puna dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT

Ligji i ri për ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087 ka ndryshuar strukturën korporative të KOSTT dhe ndërmarrjeve të tjera publike. Sipas ligjit në fjalë, Njësia e Politikave dhe Monitorimit të NP e cila është themeluar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave është kujdestar i të gjitha çertifikatave fizike, të cilat i përfaqësojnë aksionet në KOSTT, dhe që janë në pronësi të Republikës së Kosovës.

Ligji i ri nuk ka ndryshuar strukturën e menaxhmentit të KOSTT, i cili sërish udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori menaxhues (Kryeshefi ekzekutiv), që janë kompetentë për implementimin e politikës dhe strategjisë së aksionarëve.

Nga mesi i këtij viti, bazuar në Ligjin e ri për ndërmarrjet publike, filloi punën Bordi i ri i Drejtorëve të KOSTT, i cili në përbërje prej z.Faton Deda, kryesues, z.Fadil Ismajli, anëtar-drejtor menaxhues i KOSTT, z.Fadil Rrustemi, anëtar, z.Fatos Ukaj, anëtar, z.Lutfi Maxhuni, anëtar, z.Nazmi Mikullovc, anëtar dhe z.Ramadan Paçarada, anëtar, filloi punën si Bordi i parë pas pavarësimit të vendit tonë.



Në takimet e rregullta mujore të Bordit të Drejtorëve gjatë periudhës qershor-shtator 2009, janë shqyrtuar shumë dokumente të rëndësishë primare si dhe janë hartuar një sërë dokumentesh të tilla si: Plani i Biznesit për vitin 2009; Buxheti për vitin 2009 i reviduar; Pasqyrat Financiare për vitin 2008 dhe Raporti final i Auditimit 2008 pa kualifikime; Statuti i ri i kompanisë; Kodi i Etikës dhe i Qeverisjes Korporative si dhe janë marrë vendime të tjera të cilat kontribuojnë në funksionimin e KOSTT sipas standardeve dhe praktikave më të mira dhe nxisin përkushtimin edhe më tutje të punonjësve të saj për të avancuar edhe më tutje KOSTT-in si kompani publike.

Në takimin e fundit të Bordit të Drejtorëve të mbajtur në muajin shtator, anëtarët pasi që vlerësuan lartë punën e gjertanishme dhe të arriturat e KOSTT, kanë konfirmuar pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të udhëhequr nga z.Fadil Ismajli si dhe të zyrtarëve të tjerë të lartë në KOSTT.

Drejt tregut rajonal të energjisë elektrike: Çështjet e transmisionit sot dhe përfshirja e KOSTT-it



Viti 2009 do të lë gjurmë të thella në sektorin e energjisë elektrike në shumë aspekte. Negative: Efektet e krizës globale vazhdojnë të godasin ekonominë e shumë vendeve, duke shkaktuar çrregullime të tregjeve të energjisë elektrike dhe konfuzion në marrjen e vendimeve për investimet e reja. Pozitive: Procesi i liberalizimit vazhdon dhe po bëhet më i fuqishëm me pakon e re legislative të Komisionit Evropian, e zbatueshme nga marsi i vitit 2011. Koha është “e shkurtër” dhe kërkesat janë “të mëdha”. Rajoni i Evropës

Juglindore, sikur e tërë Evropa, po ndjek implementimin me veprimet paraprijëse. OST-të evropiane tanimë kanë themeluar organizatën e re ENTSO-E, sipas kërkesave të Rregullores (së re) të KE-së 714/2009 mbi kushtet për qasjen në rrjet për shkëmbime ndër-kufitare të energjisë elektrike dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 1228/2003. KOSTT tanimë ka krijuar kontaktet me ENTSO-E dhe po shqyrton anëtarësimin para se Rregullorja të fillojë të zbatohet. Me qëllim të përcjelljes së zhvillimeve, KOSTT është bërë anëtare me korrespondencë e Grupit rajonal të EJL-së të Komitetit të tregut të ENTSO-E.



Në nivel rajonal (EJL), menaxhimi i koordinuar i kongestionit mbetet çështja kryesore. Pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit për themelimin të Zyrës së Ankandit të Koordinuar dhe vendimit për lokacionin, OST-të e përfshira (përfshirë këtu KOSTT-in) kanë themeluar Komitetin Drejtues të Ekipit të Projektit, që tani është në proces të themelimit të Ekipit të Projektit të përbërë nga katër ekspertë dhe nga Menaxheri i Projektit. Ekipi i Projektit do të trajtojë drejtpërdrejtë të gjitha çështjet teknike dhe komerciale për themelimin e zyrës rajonale dhe për implementim të alokimit të koordinuar të kapaciteteve. Përkundër shumë vështirësive dhe pengesave, KOSTT-i ka arritur të jetë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm dhe në të ardhmen e afërt KOSTT-i do të jetë aksionar në këtë projekt.

Mekanizmi i balancit rajonal është gjithashtu një projekt i rëndësishëm i rajonit të EJL-së. Aranzhimi i ri bashkëpunues i OST-ve ka ngadalësuar implementimin e një mekanizmi tanimë të propozuar. Megjithatë, vendimi pritët të merret në pjesën e parë të vitit 2010.

Vendimi për të vazhduar me mekanizmin Pan-evropian për kompensimin transit ndërmjet OST (ITC) pritët të merret varësisht nga hyrja në fuqi e Udhërrëfyesit të Komisionit Evropian për ITC. Ka shumë mundësi që mekanizmi aktual do të zgjatet për disa muaj në vitin 2010, deri në marrjen e vendimit për mekanizmin e ri.

Implementimi i të gjithë mekanizmave ndër-kufitarë dhe i bashkëpunimit ndërmjet OST-ve është parakusht për themelimin e tregut rajonal të energjisë elektrike. Kjo mund të arrihet vetëm me përkushtimin politik dhe me politikat rregullative që mbështesin koordinimin dhe harmonizimin për hir të interesit të përgjithshëm dhe mbi-nacional.

Arben Kllokoqi
Tetor 2009

Kapacitetet Njerëzore në KOSTT

KOSTT është i përkushtuar në krijimin e një ambienti të sigurt për punë dhe të jetë një punëdhënës atraktiv për punëtorët e tij. KOSTT më 1 korrik 2006 ka filluar punën me 157 punëtorë dhe shumë shpejt ka funksionalizuar skemën e re organizative ku janë definuar qartë përgjegjësitë dhe obligimet e të gjithë punonjësve. Ky numër i punëtorëve është rritur gradualisht në përputhje me nevojat e kompanisë dhe KOSTT Duke marrë parasysh veprimtarinë e KOSTT, 38% të punonjësve të saj janë inxhinier, derisa mbi 50% të punonjësve janë me përgatitje superiore profesionale. Me qëllim të ngritjes së ekspertizës profesionale, KOSTT, si një nga objektivat strategjike ka edhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të kompanisë. Në kuadër të kësaj, kujdes i posaçëm i kushtohet kuadrove dhe trajnimit të tyre në mënyrë që të jemi të gatshëm që me sukses të ballafaqohemi me sfidat dhe të jemi në hap me kohën sa i përket zhvillimeve teknologjike.



Emërohen anëtarët e rinjë të Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike /Operacionale

Në dyvjetorin e themelimit dhe funksionimit të Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO), u emëruan anëtarët e rinjë të këtij trupi, të cilët do të përfaqësojnë palët relevante që operojnë në sektorin e energjisë në Kosovë për një periudhë të ardhshme dyvjeçare. Zenun Kastrati do të përfaqësoj Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Zenulla Burrniku nga SharrCem do të përfaqësoj Konsumatorët e privilegjuar, Georg Woeber nga KelKos company do të përfaqësoj gjeneruesit e pavarur të energjisë elektrike, Sadudin Havolli do të përfaqësoj Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë elektrike të Kosovës, Isak Kerolli do të përfaqësoj KEK Gjenerimin, Arif Vitija do të përfaqësoj KEK/Divizionin e Rrjetit, Sabri Tërnavë, KEK/Divizionin e Furnizimit dhe Ekrem Belegu nga Çez do të përfaqësoj tregtarët/furnizuesit e pavarur të energjisë elektrike. Në takimin e parë njohës i cili u mbajt me 11 gusht 2009, kryesuesi i radhës z.Zenun Kastrati nga ZRRë ka prezentuar para të pranishmëve të arriturat që nga funksionalizimi i KQKO-së me vëmendje të veçantë propozimet nga KQKO për amendmime të Kodeve teknike dhe aprovimet nga ZRRë. Objektivat e KQKO-së janë që të shqyrtoj dhe diskutoj Kodin e Rrjetit, Kodin e Distribucionit, Kodin e Matjes, Kodet e Standardeve dhe Pajisjeve të energjisë elektrike, Kodin për Mbrojtjen e Konsumatorëve si dhe zbatimin e tyre, dhe po ashtu ti shqyrtoj dhe diskutojë të gjitha sygjerimet për ndryshime në kodet teknike/operacionale.

KQKO
Komisioni Qeverisës i Kodeve
Operacionale



OCGC
Operational Codes Governance
Committee

Vendimet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për periudhën Maj, Qershor, Korrik, Gusht 2009



-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 23 korrik 2009, pas kërkesës së KOSTT sh.a ka aprovuar dokumentin “Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007 – 2013” (V_202_2009)


-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 27 maj 2009, në bazë të kërkesës së KOSTT sh.a ka aprovuar dokumentin “Procedura e Monitorimit të Pajtueshmërisë për Indikatorët e Performancës Teknike” (V_181_2009)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 27 maj 2009, në bazë të kërkesës së KOSTT sh.a ka aprovuar dokumentin “Propozimi për Indikatorët Minimal të Performancës Teknike” (V_181_2009)

Lajm shkurt

Forumi Ndërkombëtar “Kosova - Mundësi Energjetike”

Alb-Konfindustria, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë së Kosovës (KOSTT) dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me mbështetjen e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave të Kosovës dhe të Ministres Justina Shiroka-Pula, organizojnë Forumin Ndërkombëtar “Kosova-Mundësi Energjetike” që do të mbahet me 5-6 tetor 2009 në Prishtinë. në Forumin “Kosova – Mundësi Energjetike” janë të ftuara kompanitë më të rëndësishme publike dhe private të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga Rajoni, Europa, dhe Bota. Në Forum do të jenë të pranishëm përfaqësues të qeverive të fushave të energjisë, ekonomisë dhe financave nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor; të institucioneve rregullatore të energjisë dhe ambientit, të institucioneve financiare dhe bankare ndërkombëtare të interesuara



FORUMI NDËRKOMBËTAR “KOSOVA – MUNDËSI ENERGETIKE”

5 – 6 TETOR 2009